



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.678/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit RIMA shpk me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit S.K. avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Konak shpk me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit E.H. avokat nga Prishtina dhe H.Sh., për shkak të kompensim borxhit nga kontrata e ndërtimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike, IV.E.K.nr.18/14 datës 09.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 18.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditurës Konak shpk me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike, IV.E.K.nr.18/14 i datës 09.01.2020, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar IV.E.K.nr.18/14 të datës 09.01.2020, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si në vijim: I Aprovohet pjesërisht si bazuar kërkesëpadia e paditësit RIMA shpk me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës Konak shpk me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet e paditura që në emër të borxhit për shkak të punimeve të kryera dhe furnizimit me materiale në objektin A, njësinë banesore Prishtina Stars, palës paditëse t,ia paguaj shumën prej 10,885.00€, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, II Refuzohet pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit RIMA shpk me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës Konak shpk, e cila ka kërkuar që në emër të borxhit për shkak të punimeve të kryera dhe furnizimit me materiale në objektin A, në njësinë banesore Prishtina Stars, pala e padituri t,ia paguaj edhe shumën prej 20,786.77€, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, III Detyrohet e paditura që palës paditëse t,ia paguaj shumën prej 846.00€, në emër të kompensimit të 34% ë shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditurës V.B. avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljeve të dispozitave kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të Ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike, IV.E.K.nr.18/14 i datës 09.01.2020, i njëjti të prishet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet më tërësi si e pabazuar.

Dhoma e Shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi RIMA shpk me seli në Prishtinë, me datën 08.01.2014 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Konak shpk me seli në Prishtinë, për kompensim borxhi nga baza e kontratës së ndërtimit. Ndër të tjera në padi dhe në seancat gjyqësore ka pretenduar se me të paditurën me datën 15.08.2012 kanë lidhur kontratë për kryerjen e punimeve të instalimit elektrik në bllokun A në vend punishten Prishtina STARS. Në këtë raport kontraktues ka pasur cilësinë e punë kryesit dhe se ka pasur për detyrim kryerjen e punimeve të instalimit elektrik, në objektin në fjalë, ndërsa e paditura e ka pasur cilësinë e punëdhënësit dhe ka pasur detyrim që t,ia paguaj çmimin për punimet e kryera. Si kompensim për punët e kryera me palën e paditur janë dakorduar që e paditura t,ia jap në posedim dhe në pronësi banesën nr.43 kati 4 në Bllokun A në sipërfaqe prej 66.54m² në vlerë 950m² ndërsa pjesa tjetër të paguhet me para në shumën prej 45.000.00€ në katër pjesë. Me palën e paditur me datën 04.12.2012 kanë përpiluar një aneks marrëveshje ku kanë përcaktuar edhe disa atë drejta dhe detyrime të ndërsjella. Punë kryesi e ka njoftuar palën e paditur se duhet të bëj pranimin e përkohshëm teknik të punimeve të kryera, të gjitha vërejtjet janë evidentuar nga paditësi. Në kundërshtim me kontratën e paditura ka kërkuar që në tërë bllokun A të vendosen llampa dhe paisje të telekomunikimit, që nuk e ka pas një detyrim të tillë, pala e paditur duke u sjell me keqbesim i ka faturuar paditësin shumën prej 12,104.00€ dhe banesën e kontraktuar në emër të kompensimit e paditura ia ka shitur personit të tretë me datën 06.02.2013. E paditura nuk e ka përmbush detyrimin e saj në tërsi dhe kërkon nga gjykata që ta aprovoj kërkesëpadinë dhe ta detyroj të paditurën t,ia paguaj borxhin në emër të punimeve shtesë.

Pala e paditur në përgjigjen në padi dhe në seancën gjyqësore përmes të autorizuarit, thekson se paditësi nuk ka argumentuar bazën juridike të kërkesëpadiës, pasi që paditësi nuk i ka kryer punimet në tërsi në përputhje me marrëveshjen, Pala paditëse nuk i ka marr për bazë vërejtjet e dhëna nga e paditura dhe i ka faturuar paditësit obligimet në lidhje me punimet e papërfunduara. Fatura e prezentuar nga paditësi që i referohet instalimit të rrjetit të interfonit deri në funksionalizimin e tij ka qenë në kuadër të projektit të Bllokut A dhe paditësi ka qenë informuar që ditën e parë të fillimit të punimeve. I propozon gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datën 09.01.2020 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe administrimit të provave ka marr aktgjykimin me të cilin Aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, referohet ne nenin 17 dhe 262 par.1 të LMD-së, ndërsa gjendjen faktike lidhur me detyrimet e përmbushjes së kontratës nga palët, është referuar në raportin e ekspertizës së punuar nga grupi i ekspertëve pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, pranë Universitetit Publik “Hasan Prishtina”, ku ka rezultuar se pala e paditur nuk i ka përmbush detyrimet në tërsi ndaj paditësit duke mbetur borxh në emër të punimeve të realizuara në shumën prej 13,790.00€, e po ashtu paditësi nuk i ka përmbush detyrimet në tërsi ngase nuk e ka realizuar një pjesë të punimeve të parapara dhe atë në vlerë prej 2,905.00€, dhe nga kjo gjykata ka ardh në përfundim se e paditura ka për detyrim që paditësit t,ia kompensoj shumën prej 10,885.00€, në emër të realizimit të punimeve të furnizimit dhe instalimit elektrik në objekt. Këtë gjendje faktike sa i përket sasisë së punimeve të kryera nga paditësi dhe pagesave të kryera nga i padituri, gjykata e ka konstatuar nga raporti kontraktues i palëve dt.18.08.2012, aneks-marrëveshjen e datës 04.12.2012, vërejtjet e dhëna nga pala e paditur dt,13.11.2013, konstatimin se e paditura ka shitur banesën në objektin A kati VI nr.A43 në lagjen Emshir në Prishtinë, me çmim prej 51,500.00€, vlera e kërkesëpadisë se zbritur në shumën prej 31,671.77€, lëshimi i faturës në shumë prej 12,104.00€ nga e paditura në emër të punimeve të pa kryera. Gjykata në fund i ka falur besimin ekspertizës nga grupi i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike pranë Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, e cilësuar si ekspertizë profesionale dhe e arsyetuar në masë të mjaftueshme dhe në përputhje me shkresat e lëndës, pasi që eksperti gjyqësor Y.Z. ka dhënë konstatimin e tij se është bazuar në ditarin e punës dhe jo në komplet ditarin ndërtimor sa i përket çmimeve dhe materialeve në kryerjen e punimeve ndërtimore.

Dhoma e shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. në pikën b) të LPK, sikurse pretendohet në ankesë. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 17 të Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, në të cilin është përcaktuar se: “pjesëmarrësit në raportin detyrimor janë përgjegjës që të përmbushin detyrimet e tyre, dhe dispozitën e nenit 262 par.1 të LMD-së, që përcakton se: “kreditori në raportin detyrimor është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin në mënyrë të ndërgjegjshme”.

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës respektivisht nga provat e administruara edhe përmes ekspertizave gjyqësore, dhe deklarimeve sqaruese të ekspertëve në seanca dëgjimore, është vërtetuar me të drejt se e paditura nuk i ka përmbushur në tërësi detyrimet kontraktuese ndaj paditësit duke mbetur borxh në emër të punimeve të realizuara nga paditësi shumë prej 13,790.00€, dhe në anën tjetër gjithashtu paditësi nuk i ka përmbushur në tërësi detyrimet kontraktuese duke mos realizuar një pjesë të punimeve në shumë prej 2,905.00. Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë nga shkresat e lëndës vlerësoi se në Raportin e ekspertizës dt.05.02.2019 nga grupi i ekspertëve të Universitetit të Prishtinës, janë përmbledhur dhe sistemuar në tri kategori bilanci i vërtet i pagesave, punëve dhe shërbimeve të bëra të parapara dhe precizuar me kontrate dhe me aneks –marrëveshje, si: pagesat e që e paditura i ka bërë në konto bankare të paditësit për punët e kryera të instalimit të përgjithshëm, që janë gjithsejtë 108.80€, mungesa e pagesës nga e paditura ndaj punëve të kryera nga paditësi për të cilat nuk është kompensuar dhe që është gjithsejtë shuma 13,790.00€, dhe puna e pakryer e paditësit, bazuar në Kontrate dhe Aneks-Marrëveshjen, është dashtë ti ketë kryer dhe kjo shumë është prej 2,095.00€. Në kuadrin e obligimeve të ndërsjella të palëve ndërgjyqëse, në fund është nxjerr konstatimi i ekspertizës gjyqësore sa i përket detyrimeve të palëve në pagesën e borxhit për punën e kontraktuar.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore të së paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore apo vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Kolegji vlerëson se e paditura në ankesë dhe as në gjykatën e shkallës së parë nuk ka kontestuar apo ballafaquar vlerësimet në ekspertizën e grupit të eksperteve dt.05.02.2019, ku në tabelën 1 të ekspertizës, janë përshkruar punimet e kryera nga paditësi dhe të pakompenzuara nga e paditura, e cila gjendje është klasifikuar nga pagesat dhe faturimet e kryera, prandaj edhe Kolegji pranon se punimet e kryera shtesë në instalim nga paditësi nuk kanë qenë të përfshira në Kontratë, për çka edhe ka rezultuar gjendja reale e obligimeve të ndërsjella të palëve ndërgjyqëse në realizimin e kontraktuar të instalimit elektrik në objektin vendin punishte Prishtina Stars-objekti A. Kolegji vlerësoi se gjendja faktike është vërtetuar drejt, nga gjykata e shkallës së, ku të gjeturat nga ekspertiza e grupit të ekspertëve date 05.02.2019 nga Universiteti i Prishtinës, përputhen me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu, Kolegji i Dhomës së Shkallës së dytë i vlerëson si plotësisht të pabazuara pretendimet ankimore të së paditurës se aktgjykimi i atakuar përmban të meta nga neni 182 par.2 pika (n) e LPK-së, për arsye se sipas kësaj gjykate, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmbanë arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e shkallës së dytë. Kolegji vlerësoi se nuk janë të vlefshme pretendimet ankimore se nuk është marrë parasysh fakti se nga kanë rrjedhur detyrimet e dala për të paditurën, për arsye se nga dy ekspertizat gjyqësore të nxjerra nga gjykata e shkallës së parë, ka rezultuar me obligime të paditurës në pagimin e borxhit ndaj paditësit për punimet e instalimit të kabllove elektrike të cilat nuk ka pasur obligim ti përmbush, mirëpo edhe Kolegji pranon konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, se ekspertiza e grupit të ekspertëve dt.05.02.2019 e Universitetit të Prishtinës-Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike në Prishtinë, ka dhënë sqarime të

mjaftueshme dhe profesionale, se nga pala paditëse, ekzistojnë punë të pakryera sipas Kontratës dhe Anex-Marrveshjes në shumën prej 2,905.00€.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës të shkallës së parë, nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, nuk është përfshirë më ndonjë shkelje e cila do të ishte me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.678/23 datë 18.01.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari
Krenar Berisha